



ДРЖАВЕН ЗАВОД ЗА РЕВИЗИЈА  
ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT  
STATE AUDIT OFFICE

## ENTI SHTETËROR I REVIZIONIT

- Njoftim për mediet -


Shkup, 28.06.2021

### Kontrolli joadekuat i koncesionerëve është arsye për përdorim irracional të lëndëve të para minerale dhe realizim të vogël të të ardhurave të buxhetit

Masat dhe aktivitetet e ndërmarra nga institucionet kompetente nuk janë të mjaftueshme për të siguruar menaxhim efektiv të lëndëve të para minerale, në lidhje me shfrytëzimin optimal të tyre dhe mbledhjen efikase të tarifave të koncesionit, në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

Enti Shtetëror i Revizionit kreu revizion të suksesit me temë "Efektiviteti i masave dhe aktiviteteve për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale dhe mbledhjen e tarifave" për t'iu përgjigjur pyetjes: "Me masat dhe aktivitetet a sigurohet efektivitet në shfrytëzimin e lëndëve të para minerale si dhe mbledhjen e tarifave në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm".

Mungesa e planifikimit strategjik afatgjatë, ndryshimet e shpeshta të ligjeve, mungesa e akteve nënligjore, bashkëpunimi i pamjaftueshëm institucional dhe kadastra jo e plotë e burimeve dhe shfaqjeve të lëndëve të para minerale, nuk ofrojnë bazë të fortë për udhëheqje të politikës efektive për menaxhim me lëndët e para minerale në RMV.



Afatet e paspecifikuara dhe lidhja jo në kohë e kontratave e prolongojnë kohëzgjatjen e procedurave për dhënie të koncesioneve për lëndët e para minerale, gjë që ka implikime negative në interesin ekonomik të subjekteve, a detyrimet e pamjaftueshme të përcaktuara të koncesionerëve nuk sigurojnë mbrojtje juridike në rast të mosrespektimeve ligjore.


Koncesionerët nuk janë të detyruar ti paraqesin llogaritjet për sasi të shitura të lëndëve të para minerale, si dhe nuk janë të rregulluara çështjet e tarifave në

lidhje me sasi të e shfrytëzuara të përdorura për nevojat e tyre dhe nëse më shumë se një lëndë e parë minerale përdoret në të njëjtën zonë koncesionare.

Një strukturë e tillë sistematike për mbledhjen dhe evidentimin e tarifave të koncesionit nuk ofron mundësi për të kontrolluar llogaritjet, gjë që paraqet kufizim në kryerjen e mbikëqyrjes dhe kontrollit mbi tërësinë dhe besueshmërinë e të ardhurave nga tarifat e koncesionit.

Si rezultat i dobësive të përmendura, për periudhën 2016 - 2020, u konstatuan më pak tarifa të mbledhura koncesioni në vlerë prej 33 milion denarë, nga të cilat: 14 milion denarë në bazë të hapësirës dhe 19 milion denarë në bazë të shfrytëzimit të lëndëve të para minerale.

Për të njëjtën periudhë, me vonesë janë grumbulluar gjithsej 695 milion denarë (83 milion denarë në bazë të hapësirës dhe 612 milion denarë në bazë të shfrytëzimit të lëndëve të para minerale), për të cilat nuk është llogaritur asnjë kamatë ligjore.



← Эксплоатационен простор  
← Эксплоатационо поле надвор од експлоатационен простор

Nga katër koncesionerë që ju nënshtruan inspektimit, tre prej tyre gërmojnë lëndë të parë minerale jashtë licencës së shfrytëzimit që ata posedojnë, në një sipërfaqe totale prej 25.546 m<sup>2</sup>.

Një pjesë e koncesionerëve për lëndët e para minerale metalike nuk paraqesin dhe paguajnë tarifën për sasinë e metaleve të argjendit si dhe për koncentratin e plumbit dhe të zinkut. Tek një koncesioner, u vu re përdorim i vogël i flotacionit të metaleve të zinkut, si dhe një përqindje e madhe e rrjedhjeve në

pellgun e mbeturinave.

Revizioni konsideron të domosdoshme të theksojë se, pas inspektimit dhe indikacioneve nga revizioni tek koncesionerët, janë paguar 10 milion denarë shtesë.

Kryerja e inspektimeve pa kritere të përcaktuara për përzgjedhjen e subjekteve, zbatimi jo i plotë i inspektimeve të rregullta të planifikuara, inspektimet e kryera pjesërisht të vendimeve të lëshuara për eliminimin e parregullsive, mungesa e një laboratorit të pavarur të akredituar, mungesa e burimeve financiare dhe pajisjeve, nuk mundësojnë mekanizëm efektiv të kontrollit.

Në drejtim të shmangies së gjendjeve të konstatuara revizioni dha rekomandime për përmirësimin e situatës në pjesën e: vendosjes ligjore dhe institucionale të

sistemit të menaxhimit të lëndëve të para minerale, funksionalitetit dhe efektivitetit të procedurave për dhënien/revokimin e koncesioneve për lëndët e para minerale, mbledhjen e tarifave të koncesionit dhe mekanizmit të vendosur për mbikëqyrjen dhe kontrollin mbi funksionimin e koncesionerëve, në mënyrë që lëndët e para minerale të përdoren në mënyrë optimale në përputhje me parimet e zhvillimit të qëndrueshëm.

**Link deri tek raporti: Efektiviteti i masave dhe aktiviteteve për shfrytëzimin e lëndëve të para minerale dhe mbledhjen e tarifave**

**Press kontakt:**

**Albiona Mustafa Muhaxhiri +389 72 228 203**

albiona.mustafa@dzr.gov.mk

**Mijalçe Durgutov +389 70 358 486**

mijalce.durgutov@dzr.gov.mk

**Martin Duvnjak +389 75 268 517**

martin.duvnjak@dzr.gov.mk